

MENDIM PAKICE

Unë, komisioner Lulzim Hamitaj, si anëtar i trupit gjykues, nuk pajtohem me vendimin e marrë nga kolegët e shumicës, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Endrit Bimi, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak se subjekti i rivlerësimit, sipas mendimit tim, nuk arriti një nivel të besueshëm në rivlerësimin e pasurisë, për sa kohë nuk ka justifikuar me burime të ligjshme pasuritë e personave të lidhur. Gjithashtu, nisur nga konstatimi i disa fakteve dhe rrethanave që lidhen me kriterin e pasurisë, të cilat të gërshetuara me përmbajtjen e disa prej denoncimeve të publikut dhe të çmuara së bashku me problematikat e konstatuara edhe në kriterin e aftësive profesionale, në një vlerësim të përgjithshëm, çojnë në cënimin e besimit të publikut – sipas jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Konkretisht, si anëtar në pakicë/kundër, jam shprehur dhe kam votuar kundër konkluzioneve dhe rezultateve të hetimit administrativ që i janë njoftuar subjektit, pasi vlerësoj se ato duhet të ishin të ndryshme – siç analizohet dhe specifikohet në vijim dhe, rrjedhimisht, subjekti i rivlerësimit nuk duhet të ishte konfirmuar në detyrë, pasi nga hetimi administrativ, i kryer nga Komisioni, ka rezultuar se:

1. Lidhur me gjendjet dhe depozitat financiare të bashkëjetueses së subjektit

Ka rezultuar se znj. L. K., në cilësinë e personit të lidhur me subjektin, në deklaratën *Vetting*, ka përshkruar në disponimin e likuiditeteve si vijon:

- i. Fondi i Investimit në lekë në vlerën 1,700,000 lekë;
- ii. Fondi i Investimit në euro në vlerën 10,000 euro;
- iii. llogari biznesi me gjendje në vlerën 1,193 lekë;
- iv. llogari rrjedhëse në lekë me gjendje në vlerën 145,502 lekë;
- v. depozitë bankare në euro, në vlerën 7,606.40 euro;
- vi. depozitë bankare në euro, në vlerën 3,131.52 euro;
- vii. depozitë bankare në dollar, në vlerën 24,606 USD.

Gjithashtu, në deklaratën e vitit 2014, znj. L. K. ka deklaruar se dispononte në gjendje/depozita, në “Raiffeisen Bank”, vlerat monetare si vijon: (i) 2,000,000 lekë; (ii) 10,700 euro; (iii) 24,500 USD; si dhe (iv) gjendje *cash* në banesë, në vlerën 1.350.000 lekë.

Nisur nga fakti që të gjitha shumat e mësipërme, sipas shpjegimeve të subjektit dhe të znj. L. K. – qartësuar edhe përgjatë seancës dëgjimore – janë krijuar prej saj nëpërmjet kursimeve të familjes së origjinës të akumuluar, ndër vite, për të cilat ILDKPKI-ja ka konstatuar pamundësinë financiare me burime të ligjshme për krijimin e tyre, për sa kohë kanë vijuar të disponohen edhe në momentin e deklaratës *Vetting*, subjekti ka detyrimin e justifikimit të tyre.

Sa më lart përkon edhe me konstatimet dhe veprimet hetimore të kryera nga Komisioni përgjatë hetimit administrativ, sikurse janë shprehur në paragrafin 30 (depozitë bankare) të vendimit të shumicës, pakica nuk ndan të njëjtin mendim lidhur me konkluzionin e arritur mbi mundësitë financiare me burime të ligjshme për të kursyer/krijuar shumat e lartpërmendura. Pakica

vlerëson se familja e znj. L. K. nuk kishte burime të ligjshme për të kursyer shumat në fjalë, për sa kohë të ardhurat e tyre – në masën e provuar dhe sikurse janë përshkruar dhe konsideruar në analizën financiare nga Komisioni – nuk mjaftojnë për të mbuluar të gjitha shpenzimet, investimet dhe për të kursyer edhe likuiditetet monetare të disponuara nga familja K., deri në fund të vitit 2012.

Konkluzioni i pakicës mbi pamjaftueshmërinë financiare të familjes K. bazohet mbi rezultatin e ndryshëm që del krahasimisht me analizën e kryer nga shumica në pikën 30.3 të vendimit përkatës nëse do të konsideroheshin dhe përlllogariteshin në këtë analizë financiare të gjitha investimet e kryera prej tyre në pasuri të paluajtshme.

Për të qartësuar sa më sipër, vërehet se:

- a- Së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, datë 22.6.2021, subjekti i rivlerësimit ka bashkëngjitur dokumentet provuese të pasurive të paluajtshme të përfituara nga familja e origjinës së bashkëjetueses, konkretisht: 7 certifikata pronësie të pasurive të regjistruara deri në vitin 2012; 2 certifikata pronësie të pasurive të ndërtimeve shtesë, të legalizuara; 2 certifikata pronësie të pasurive të regjistruara pas vitit 2012; si dhe 1 certifikatë pronësie e një pasurie të trashëguar.
- b- Konkretisht, ka rezultuar se – përveç investimit të kryer në vitin 2008 në vlerën 3,843,000 lekë, i vetmi i përfshirë në analizën financiare në tabelën e pikës 30.3 – përgjatë periudhës 1994 – 2012, prindërit e bashkëjetueses së subjektit kanë blerë edhe pasuritë e mëposhtme:
 1. apartament me sipërfaqe 120 m², me nr. pasurie ***, të ndodhur në rrugën “A. Z. Ç.”, Tiranë, blerë me kontratën e shitblerjes, datë 20.12.2001, kundrejt çmimit 56,400 USD;
 2. apartament me sipërfaqe 41.6 m², me nr. pasurie ***, të ndodhur në K., K, blerë me kontratën, datë 7.9.2005, kundrejt çmimit 1,250,000 lekë;
 3. apartament me sipërfaqe 67.7 m², me nr. pasurie ***, të ndodhur në K., K, blerë me kontratën, datë 7.9.2005, kundrejt çmimit 1,950,000 lekë;
 4. apartament me sipërfaqe 65 m², me nr. pasurie ***, të ndodhur në K., K, blerë me kontratën, datë 7.9.2005, kundrejt çmimit 1,900,000 lekë.
- c- Gjithashtu, nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se nga llogaritë e babait të bashkëjetueses së subjektit është transferuar gjatë vitit 2010 shuma 45,000 euro, për blerje apartamenti (përkatësisht shumat 35,000 euro nga llogaria në “Raiffeisen Bank” dhe 10,000 euro nga “Alpha Bank”).
- d- Përveç apartamenteve të përmendura më sipër, kanë rezultuar të regjistruara në emër të prindërve të bashkëjetueses së subjektit edhe këto pasuri, për të cilat nuk disponohen të dhëna mbi vlerën e investimit:
 5. apartament me sipërfaqe 50 m², me nr. pasurie ***, të ndodhur në rrugën “M. P.”, Tiranë;
 6. apartament me sipërfaqe 50 m², me nr. pasurie ***, të ndodhur në rrugën “M. P.”, Tiranë;
 7. apartament me sipërfaqe 50 m², me nr. pasurie ***, të ndodhur në rrugën “M. P.”, Tiranë;

8. apartament me sipërfaqe 52.21 m², me nr. pasurie ***, të ndodhur në rrugën “H. H. D.”, Tiranë.

e- Po ashtu, përtej sa më sipër cituar, në vitin 2017 janë legalizuar dy pasuri – të cilat kanë pasur një kosto ndërtimi e legalizimi, por mbeten të panjohura – dhe konkretisht:

9. njësi me sipërfaqe 35.8 m², me nr. pasurie ***, Tiranë;

10. shtesë/apartament me sipërfaqe 21.6 m², me nr. pasurie ***, Tiranë.

Në vijim të sa më sipër, duke përfshirë në analizën financiare përkatëse, së paku (vetëm) investimet e identifikuara, që i përkasin periudhës së analizuar deri në vitin 2012, duke i mbajtur të pandryshuara të dhënat e tjera – siç është përkrahur në tabelën që vijon – rezultati final pasqyron një bilanc negativ të familjes K., minimalisht në masën 17,521,411 lekë.

	TOTAL
PASURI	24 320 350,39
Pasuri të paluajtshme	22 918 387,26
Pasuri të luajtshme	771 155,00
<i>Ndryshim (shtesë/pakësim) likuiditeti</i>	6 877 258,13
	0,00
TË ARDHURA	22 162 270,58
Të ardhura nga klinika	14 737 900,00
Të ardhura L. K.	553 800,00
Të ardhura nga shitja e pasurive të luajtshme	250 000,00
Të ardhura nga qiratë	2 964 279,85
Të ardhurat e E. P. (gjyshja) pension në Shqipëri	1 105 778,10
Të ardhurat e E. P. (gjyshja) pension në Greqi	2 790 512,62
SHPENZIME	9 465 130,00
Shpenzime jetike	9 465 130,00
Rezultati i analizës financiare	- 17 521 411,56

Nga sa më sipër, konstatohet se të ardhurat e dokumentuara me burim të ligjshëm, të përfituara nga e gjithë familja K., në total në vlerën 22,162,271 lekë, nuk janë të mjaftueshme për të kryer investimet e kryera në pasuri të paluajtshme, përkatësisht (dhe pjesërisht) në vitet 2001, 2005, 2008 dhe 2010, që arrijnë në një shumë totale shpenzimi prej 22,918,387 lekësh – të përfshira në tabelën e mësipërme.

Për rrjedhojë, ka rezultuar një pamjaftueshmëri e burimeve të ligjshme financiare për investimet në depozitat me afat të kryera nga bashkëjetuesja e subjektit, së paku në shumën prej 4,465,138 lekësh, të cilat janë krijuar me të njëjtat burime të kësaj analize dhe brenda periudhës së analizuar (1994 – maj 2013), përkatësisht: (i) shuma 600,000 lekë, investuar në “Raiffeisen Invest”; (ii) shuma 7,013 euro, investuar në depozitë me afat në “Raiffeisen Bank”;

(iii) shuma 3,000 euro, investuar në depozitë me afat në “Raiffeisen Bank”; (iv) shuma 24,040 USD, investuar në depozitë me afat në “Raiffeisen Bank”.

Si pasojë e sa më sipër, ka rezultuar se bashkëjetuesja e subjektit nuk ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare, as për të krijuar kursimet e pretenduara në *cash* në masën (-)1,350,000 lekë, të deklaruara me burim nga të ardhurat nga klinika dentare¹ dhe të përdorura më pas për depozitim të tyre në sistemin bankar në vitin 2016.

Lidhur me mangësitë financiare deri në vitin 2012 të bashkëjetueses së subjektit, në shumën totale (-)5.815.138 lekë (nga të cilat: (-) 4,465,138 lekë për depozitat bankare dhe në masën (-) 1,350,000 lekë, për kursimet e pretenduara *cash*), pakica, duke mbajtur në vëmendje qëndrimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit², çmon se këto pamjaftueshmëri financiare, për sa kohë i referohen një periudhe para nisjes së bashkëjetesës dhe cilësimit të znj. L. K., si person i lidhur me subjektin, (sipas deklaratës së tij), ndonëse nuk mjaftojnë për të aplikuar një masë disiplinore, sipas pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, si një shkak më vete shkarkimi, ato mjaftojnë për të arritur në konkluzionin se subjekti nuk arriti një nivel të besueshëm për kriterin e pasurisë dhe, sipas pikës 2, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, do të vlerësohen në tërësinë e procesit të rivlerësimit që është kryer ndaj subjektit.

2. Lidhur me automjetin tip “Mercedes-Benz”, në emër të bashkëjetueses së subjektit

Kjo pasuri është përfituar prej bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit me kontratën e shitblerjes, datë 14.5.2013, kundrejt çmimit 5,500 euro. Burimi i krijimit është deklaruar dhuratë nga babai.

Edhe lidhur me këtë investim të znj. L. K., pakica nuk është dakord me konkluzionin e arritur sa i përket mundësisë financiare të babait për të dhuruar këtë shumë, pasi sipas analizës financiare të kryer më lart mbi të ardhurat e familjes së bashkëjetueses përgjatë periudhës 1994 – 2012, për të evidentuar mundësitë e tyre për kryerjen e këtij dhurimi me burime të ligjshme financiare, është konstatuar një bilanc negativ me mbi 1.700.000 lekë dhe nuk kanë rezultuar të ardhura të tjera të përfituara përgjatë periudhës janar – prill 2013, që, pasi të përballoheshin shpenzimet e tjera, të mund të justifikonin me burime financiare të ligjshme dhurimin në fjalë.

Për rrjedhojë, ka rezultuar një pamundësi financiare e bashkëjetueses së subjektit në vitin 2013 përgjatë bashkëjetesës, për të kryer blerjen e automjetit në shumën 5,500 euro ose 771,155 lekë.

3. Lidhur me apartamentin në rrugën “M. P.”, Tiranë, në emër të z. A. K.

Ka rezultuar se kjo pasuri është përfituar prej babait të bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit, z. A. K., me kontratën e shitblerjes, datë 19.6.2017, kundrejt çmimit 130,000 euro (17,290,000 lekë). Ndonëse kjo pasuri është krijuar disa muaj pas deklaratës *Vetting* dhe nga një person tjetër i lidhur, për shkak të huadhënies, është çmuar nga Komisioni që të analizohej

¹Këto kursime gjithsesi nuk mund të ishin me burim nga të ardhurat e klinikës në emër të bashkëjetueses së subjektit, pasi referuar të dhënave të DRT-së Tiranë, ky aktivitet nuk ka deklaruar xhiro apo fitime për vitet 2010, 2011, 2012 dhe 2013. Ndërsa, për vitin 2014 të ardhurat nga klinika dentare kanë qenë vetëm 287,503 lekë, dukshëm të pamjaftueshme për të krijuar kursimet e pretenduara *cash* në shumën 1,350,000 lekë, dhe znj. L. K. ka pohuar në seancë dëgjimore se ato ishin krijuar përpara vitit 2013 – kur ka nisur bashkëjetesa me subjektin.

²Vendimi nr. 15/2021, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

burimi, pasi aty janë investuar të gjitha kursimet e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëjetueses, të cilat janë krijuar përgjatë shumë vitesh më herët e deri në vitin 2016.

Nga analizimi i dokumentacionit të administruar ka rezultuar se blerja e pasurisë në fjalë është kryer me përdorimin e disa fondeve monetare, me burim dhe zotërim, si vijon:

- a) vlera 17,000 euro është transferuar nga llogaria e z. A. K. në “Alpha Bank”. Kjo shumë është krijuar nga të ardhurat nga qiradhënia, nga një pjesë e të ardhurave të pensionit të nënës, si dhe dy depozitime *cash* të kryera prej z. A. K., në shumat 2,080 euro në datën 14.1.2016 dhe 7,000 euro në datën 11.5.2017;
- b) vlera 9,594 euro ose 1,275,068 lekë hua nga subjekti i rivlerësimit;
- c) vlera 22,573 euro ose 3,000,000 lekë hua nga subjekti i rivlerësimit;
- d) vlera 15,801 euro ose 2,100,000 lekë të transferuara nga bashkëjetuesja e subjektit, të tërhequra prej saj nga fondi i investimit në “Raiffeisen Bank”, të investuara fillimisht, përgjatë periudhës 2012 – 2015, në shumën 1,700,000 lekë dhe shtuar me interesa ndër vite;
- e) vlera 16,825 euro ose 2,236,063 lekë të transferuara nga z. A. K. nga fondi i investimit në “Raiffeisen Invest”;
- f) vlera 7,300 euro të transferuara nga bashkëjetuesja e subjektit;
- g) vlera 6,000 euro të depozituara *cash* nga z. A. K., me përshkrimin “të ardhura nga puna si mjek stomatolog”;
- h) vlera 22,006 euro ose 24,559 USD të transferuara nga bashkëjetuesja e subjektit, në llogarinë e babait të saj - shumë kjo e përfutur po nga babai i saj dhe e kaluar në emër të L. K. në vitin 2011, dhe e shtuar, ndër vite, me interesat përkatës;
- i) vlera 7,405 euro ose 8,264 USD të transferuara nga subjekti në llogarinë e z. A. K.;
- j) vlera 5,591 euro të transferuara nga z. A. K. nga fondi i investimit në “Raiffeisen Invest”, të investuara prej tij fillimisht në shumën 5,300 euro, depozituara këto gjatë vitit 2012.

Nga sa më sipër, duket se shuma e dhënë hua nga subjekti i rivlerësimit, në favor të z. A. K., ka qenë në vlerën 39,572 euro, ndërsa transferimet e kryera nga bashkëjetuesja e subjektit, në llogarinë bankare të babait të saj, kanë qenë në vlerën 45,107 euro, ndërsa investimi i kryer nga vetë babai i bashkëjetueses së subjektit ka qenë në vlerën 45,416 euro.

Në vijim të analizimit të pasurisë së mësipërme, duket se nga shuma e transferuar nga bashkëjetuesja e subjektit prej 45,107 euro (të konvertuara në 5,994,720 lekë) të transferuara prej saj në llogari të babait, përveç shumës 1,000,000 lekë (nga 1,700,000 lekë të investuara në fondin e “Raiffeisen Invest”), diferenca prej 4,994,720 lekësh është krijuar dhe depozituar më herët, me burim nga të ardhurat e periudhës së analizuar, 1994 – 2013, në shumën 4,465,138 lekë të sipëranalizuar, të cilave u janë shtuar interesat ndër vite. Për pasojë, kjo shumë nuk mund të krijohej me burime të ligjshme financiare. Ndërsa, për shumën 1,000,000 lekë të depozituar pas fillimit të bashkëjetesës, nëntor 2013 – shkurt 2015, janë përfshirë në analizën financiare dhe ka rezultuar se mund të krijoheshin/kurseheshin me burime të ligjshme financiare.

Por, ndërkohë që kursimet e subjektit kanë rezultuar me burime të ligjshme dhe kursimet e bashkëjetueses janë analizuar më sipër dhe kanë rezultuar pa burime të ligjshme financiare të

mjftueshme, në këtë pikë meriton një shqyrtim dhe një analizë burimi financiar i shumave të paguara nga z. A. K., në vlerën 45,416 euro (konvertuar në 6,035,786 lekë).

Nisur nga rezultatet e analizës financiare të kryer më sipër për familjen K., deri në fund të vitit 2012, - nga ku është konstatuar një pamjaftueshmëri e theksuar mjetesh monetare me burime të ligjshme - duke analizuar edhe të gjitha të dhënat e tjera të administruara nga Komisioni, ka rezultuar se:

- a- shuma 8,000 euro – (pjesë e shumës 17,000 euro të paguara për këstin e parë të kësaj pasurie) – ka burim të ligjshëm, pasi rrjedh nga të ardhurat e përfituara nga qiradhënia dhe nga pensioni i vjehrrës së z. A. K.;
- b- ndërsa diferenca e paguar nga z. A. K. për këtë pasuri në shumën 37,416 euro (ose 4,972,586 lekë) është krijuar nga të ardhurat e mëhershme³, përpara vitit 2013, të analizuara më sipër, të cilat nuk rezultojnë të kenë pasur burime të ligjshme financiare. Për pasojë, në mungesë të ndonjë burimi tjetër të të ardhurave⁴ nga prindërit e bashkëjetueses, ka rezultuar se z. A. K. nuk ka pasur burime të ligjshme financiare për të investuar këto shuma për blerjen e pasurisë në analizë.

Në përfundim, për rrjedhojë të sa më sipër është analizuar, kjo pasuri e blerë nga z. A. K., më datë 19.6.2017, kundrejt çmimit 130,000 Euro, - për sa kohë nuk është provuar burimi i ligjshëm i shumave të disponuara/investuara nga bashkëjetuesja e subjektit dhe nga babai i saj - rezulton me një pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare në vlerën prej (-) 9,437,724 lekë.

Në këto kushte, nisur nga rezultatet e analizave financiare që evidentojnë mungesa të mjeteve monetare të ligjshme, të përdorura për këtë pasuri dhe duke mbajtur në vëmendje mungesën e logjikës dhe/ose të shkaqeve bindëse të veprimeve dhe qasjeve të subjektit, lidhur me: (i) investimet e të gjitha kursimeve, si të subjektit dhe të bashkëjetueses në blerjen e apartamentit me sip. 145 m² nga z. A. K., në formën e një huaje pa interes, pa afat – pa kthim pas të asnjë shume të huadhënies prej mbi 4 vjetësh; (ii) ndërkohë që subjekti ka të drejta reale vetëm për 1/9 e apartamentit të ndërtuar përpara viteve 1990, të legalizuar nga prindërit e tij, ndërkohë që për familjen K. ky apartament është pasuria e tyre e paluajtshme nr. *** dhe në rrugën “M. P.” ata dispononin pasuri të tjera të paluajtshme; (iii) shumat e dhuruara nga familja K. për bashkëjetuesen e subjektit nga kursimet e tyre, ndër vite, me qëllim ndihmesën për familjen e re që po krijonte, i rikthehen sërish babait të saj – i cili mund të shiste ndonjë prej pasurive të paluajtshme në zotërim, për të mundësuar blerjen e këtij apartamenti, nëse kishte nevojë reale; (iv) pamundësia financiare me burime të ligjshme, për pagesën e shumave të konsiderueshme, të investuara nga z. A. K., nga një vlerësim i përbashkët/përgjithshëm i këtyre rrethanave, krijohet bindja se ky apartament realisht është blerë nga subjekti dhe bashkëjetuesja e tij, por është vepruar formalisht në mënyrë fiktive në emër të babait të kësaj të fundit, me qëllim fshehjen e pronësisë reale, për të shmangur këssoj verifikimin dhe pasojat e pamundësisë për

³Pasi aktiviteti privat i z. K. është mbyllur në vitin 2010, pensioni nga shteti grek i vjehrrës së tij është përfituar deri në vitin 2013, si dhe të ardhurat nga qiradhënia janë të përfshira deri në vitin 2010, pasi ato të vitit 2013 nuk janë përfshirë si të ardhura me burim të ligjshëm, për sa kohë nuk ishin paguar detyrimet tatimore.

⁴Përveç të ardhurave nga pensionet në Shqipëri, të cilat gjithsesi do të shkonin për mbulimin e shpenzimeve jetike.

të justifikuar mjetet e tyre financiare, për pjesën e pretenduar si të paguar nga z. A. K., me burimet e tij.

4. Apartament banimi në rrugën “M. P.”, Tiranë, i blerë në emër të nënës së subjektit

Kjo pasuri është përfituar nga nëna e subjektit me kontratën e shitblerjes, datë 7.5.2019, kundrejt çmimit 95.000 USD.

Lidhur me këtë apartament, përgjatë procesit të rivlerësimit, subjekti ka deklaruar se nuk ka pasur asnjë kontribut financiar për këtë blerje. Ndërkohë, siç është evidentuar nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni – përpos problematikave procedurale mbi përfitimin e shumës prej 4,161,365 lekë nga babai i subjektit, i ndjeri E. B., (që do të trajtohet më poshtë), shumë kjo e cila, më pas, u bë pjesë e trashëgimisë ligjore – së paku shuma 702,460 lekë ka rezultuar të jetë tërhequr prej subjektit të rivlerësimit nga llogaria e përbashkët e prindërve, si pjesa e tij takuese dhe të jetë depozituar, më pas, në llogarinë bankare në emër të nënës. Në këto kushte kontributi financiar i subjektit në blerjen e kësaj është evident, për sa kohë është përdorur një shumë që *de jure* i përkiste atij, - në cilësinë e trashëgimtarit, - dhe që edhe *de facto* ai e ka disponuar/tërhequr dhe me vetëdije e vullnet të lirë e ka kaluar në emër të nënës së tij, për ta përdorur pikërisht për blerjen e pasurisë *de qua* prej saj.

Gjithashtu, përveç shumës së mësipërme prej 4,161,365 lekësh, fondet e tjera të përdorura për blerjen e kësaj pasurie, nga nëna e subjektit, kanë qenë si vijon:

- a. Shuma 2,001,059.06 lekë e transferuar nga llogaria e nënës së subjektit në “Credins Bank” në llogarinë e saj në BKT. Kjo shumë është krijuar përkatësisht nga transferimet e kryera nga llogaria e përbashkët e të dy prindërve të subjektit:
 - 1.a shuma prej 771,035.74 lekësh, e cila ka qenë fillimisht e investuar në bono thesari në emër të babait të subjektit, në datën 5.11.2009, në vlerën 750,000 lekë e riinvestuar çdo vit deri në datën 27.11.2014, kur është transferuar në “Credins Bank”, në një llogari dyemërore të subjektit me babanë, në shumën 747,255 lekë. Në datën 1.12.2014, shuma në fjalë është transferuar në llogarinë dyemërore të prindërve të subjektit dhe është shtuar, më pas, me interesa deri në vitin 2019;
 - 2.a shuma 1,232,723.32 lekë, e cila ka qenë fillimisht e investuar në bono thesari në emër të babait të subjektit në datën 16.4.2009, në vlerën 1,300,000 lekë e riinvestuar çdo vit deri në datën 9.4.2015, kur është tërhequr dhe depozituar prej tij në llogarinë dyemërore së bashku me bashkëshorten. Më pas, nëna e subjektit e ka transferuar shumën në llogarinë e saj në datën 3.5.2019.
- b. Shuma prej 1,183,500 lekësh e transferuar nga llogaria e nënës së subjektit në “First Investment Bank”, në llogarinë e saj në BKT. Shuma prej 1,000,000 lekësh është depozituar fillimisht nga nëna e subjektit në datën 9.10.2012, e cila është shtuar, më pas, me interesat, ndër vite, deri në vitin 2019, kur është transferuar.
- c. Shuma prej 11,985 euro është krijuar nga depozitimi *cash* i shumës prej 11,000 euro nga nëna e subjektit në datën 9.10.2012, në llogarinë e saj në “First Investment Bank” dhe, më

pas, është shtuar me interesa, ndër vite, deri në vitin 2019. Kjo shumë është tërhequr dhe është konvertuar në vlerën 13,393 USD.

- d. Shuma prej 14,975 USD është transferuar nga vëllai i subjektit, z. M. B., në datën 3.5.2019 – dhe është i vetmi burim i ligjshëm dhe i qartë lidhur me krijimin dhe transferimin.

4.1 Nga analiza e mjeteve monetare të lartpërshkruar, vlerësohet se, me përjashtim të pikës “d” (shuma prej 14,975 USD e përfituar nga nëna e subjektit pas deklaratës *Vetting*), të gjitha shumat e tjera duhet të analizohen në kuptimin e burimit të ligjshëm për dy arsye: (i) për sa kohë ato janë krijuar/depozituar përgjatë periudhës së bashkëjetesës me subjektin – pasi ata kanë jetuar gjithmonë në të njëjtën familje/banesë dhe, *de facto*, janë persona të lidhur; (ii) këto shuma janë kursyer përgjatë periudhës që subjekti ka ushtruar detyrën e prokurorit; (iii) mjetet monetare në fjalë janë disponuar gjendje si likuiditete/depozita edhe në momentin e deklaratës *Vetting*; (iv) subjekti rezulton trashëgimtar ligjor i 1/3 pjesë të pasurive të babait, të ndjerit E. B.; (v) ka rezultuar se edhe pjesa takuese e gjendjeve dhe depozitave bankare të trashëguara nga babai i subjektit janë investuar tërësisht në këtë pasuri, duke e bërë kështu subjektin një kontribues *de facto* nëpërmjet përdorimit pikërisht të pjesës së tij takuese në cilësinë e trashëgimtarit ligjor, në masën prej 1/3.

Ndonëse, subjekti ka pretenduar se shumat e depozituara apo gjendje në llogaritë e prindërve të tij, përkatësisht në vitet 2004, 2009 dhe 2012, janë dërguar nga vëllai dhe kanë burim nga të ardhurat e tij nga emigracioni në shtetin kanadez dhe atë amerikan, por ka mbetur në nivel deklarativ për sa kohë nuk janë provuar këto rrethana. Për sa i takon këtyre të ardhurave, të krijuara/depozituara dhe të disponuara nga prindërit e subjektit, në llogaritë e tyre bankare në shumën totale të përfshirë në analizë prej 5,272,450 lekësh, nuk ka rezultuar ndonjë dokumentacion që të provojë kohën dhe mënyrën e dërgimit apo sjelljen e tyre nga vendi i origjinës për në Shqipëri, përpos faktit që nuk përkojnë as periudhat kohore me shkaqet e pretenduara. Gjithashtu, nga dokumentacioni i administruar nuk ka rezultuar ndonjë përshkrim në depozitimet e kryera prej nënës apo babait të subjektit, ku të përmendet si burim emigracioni apo emri i vëllait të subjektit, si dërgues, lidhur me këto të ardhura. Për pasojë, nisur edhe nga jurisprudenca tashmë konstatante e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit⁵, në mungesë të provave se këto të ardhura vërtet burojnë nga puna në emigracion e vëllait të subjektit, dhe mbi mënyrën dhe kohën e transferimit të tyre në Shqipëri, ato nuk mund të konsiderohen me burim të ligjshëm, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, dhe për rrjedhojë as nuk mund të përfshihen në analizën financiare të familjes së subjektit. Ky vlerësim përforcohet edhe nga fakti që nuk duket bindës shpjegimi i subjektit me prapsimet e tij, se vëllai i kishte sjellë të ardhurat në fjalë, ndër vite, për të kontribuar në blerjen e këtij apartamenti. Në fakt duket alogjike që dikush të nis të ardhura në periudhën 2004 – 2012 për një blerje të kryer në vitin 2019. Ndërkohë që, sikurse është nisur me transfertë shuma e lart përmendur në vitin 2019, në prag të investimit të kryer nga nëna e subjektit, ashtu mund të ishte nisur edhe ndonjë vlerë tjetër më e madhe, në momentin e duhur dhe jo shumë vite më herët. Për më tepër që nuk ka asnjë provë dhe arsye që kjo pasuri të jetë blerë nga nëna pasi ishte si qëllim investimi nga vëllai i subjektit, i cili as nuk e ka parë/zgjedhur vetë apartamentin e blerë nga nëna e tij, për sa kohë nuk ka qenë prezent

⁵ Veç vendimeve të tjera të mëherëshme, ky qëndrim është konfirmuar edhe në vendimin e KPA-së, nr. 14/2021, paragrafi 44.

në territorin shqiptar në atë vit. Për rrjedhojë, nuk kuptohet shkaku i ngutit për këtë blerje pikërisht në vitin kur z. M. B. nuk ka ardhur në Shqipëri, por mund të ishte blerë në vitin 2018 apo në vizitën e tij të radhës në Shqipëri - nëse kjo pasuri vërtet do të ishte bërë për llogari dhe vullnet të vëllait të subjektit.

Nga sa më sipër, duket se përveç shumës prej 14,975 USD të dërguar nga vëllai i subjektit, z. M. B., të gjithë shumat e tjera të përmendura në pikat “a”, “b” dhe “c”, të depozituara e disponuara prej njërit ose të dy prindërve të subjektit, - veç faktit që nuk kanë burime të ligjshme, - ato kanë qenë pjesë përbërëse e pasurisë së luajtshme në regjimin martesor dhe, për rrjedhojë, edhe këto shuma kanë qenë objekt i trashëgimisë dhe i pjesëtimit të 50% të pasurisë prindërore, në vitin 2017, pasi ka ndërruar jetë i ndjeri E. B..

Në zbatim të dispozitave ligjore përkatëse mbi trashëgiminë dhe sipas së njëjtës logjikë të ndjekur nga anëtarët e familjes së subjektit, duke e konkretizuar, edhe *de facto*, pjestimin/rrgjistrimin e pjesëve takuese të apartamentit të privatizuar nga prindërit, (ku subjekti banon dhe zotëron 1/9), si dhe ndarjen e shumës prej rreth 4,2 milion në llogarinë e prindërve në BKT në favor të trashëgimtarëve, do të duhej të kishin pjestuar edhe shumat e sipërcituara në total 42,212 USD (ose 4,664,500 lekë), nga ku subjekti ka përfituar *de jure* 1/6 pjesë (pra 1/3 e 50% të totalit), që përkon me shumën 777,418 lekë.

Nisur nga sa më sipër, rezulton se shuma totale që i përket subjektit nga likuiditetet financiare, si një prej trashëgimtarëve ligjorë të babait të ndjerë, në total arrin në vlerën prej 1,479,878 lekë, e cila tërësisht është investuar në apartamentin e blerë nga nëna e subjektit. Kjo rrethanë çon në konkluzionin se kjo vlerë monetare *de facto* është një kontribut (i heshtur) i subjektit, për sa kohë prej tij as nuk është nënshkruar ndonjë akt mospranimi i trashëgimisë dhe as nuk është deklaruar shuma në fjalë si dhurim apo huadhënie në favor të nënës.

Lidhur me këtë pikë, subjekti, pasi është pyetur edhe në seancë dëgjimore, ka mohuar jo vetëm kontributin e tij financiar në këtë pasuri, por edhe dijeninë mbi ekzistencën e këtyre shumave likuiditete, pasi ka ndërruar jetë babai i tij. Ky pretendim nuk është bindës pasi, siç u citua edhe më sipër, subjekti ka qenë i vetëdijshëm dhe i përfshirë si trashëgimtar dhe ka përfituar e regjistruar në emër të tij 1/9 pjesë (1/3 e 50%) të apartamentit të privatizuar nga prindërit më herët. Pretendimi i subjektit se të gjitha shumat ishin të prindërve nuk qëndron dhe bie ndesh me përmbajtjen e dëshmisë së trashëgimisë ligjore të datës 30.10.2017 dhe me dispozitat ligjore përkatëse. Kjo qasje mohuese e realitetit prej subjektit dhe shpjegimet e tij jo bindëse ngrenë dyshime mbi tentativën për të shmangur përfitimet, në pjesën takuese *de jure*, mbi pasuritë e luajtshme të babait të ndjerë, për të evituar kësisoj, pikërisht nënshtrimin e këtyre vlerave monetare në kontrollin e ligjshmërisë së përfitimit dhe të burimeve të krijimit të tyre. Kjo qasje mohuese e një realiteti faktiko-ligjor, mbi përkatësisë e pjesës takuese edhe të pasurive të luajtshme, të njohur minimalisht nga çdo jurist, dhe shpjegimet jo bindëse dhe kontradiktore me faktet, kontribuojnë në cënimin e besimit e publikut tek figura e magjistratit dhe do të vlerësohen në tërësinë e procesit të rivlerësimit të kryer ndaj subjektit.

Në këto kushte, vlerësohet se kemi të bëjmë me një kontribut financiar në shumën 1,479,878 lekë prej subjektit të rivlerësimit në këtë pasuri të blerë vetëm në emër të nënës së tij dhe, për rrjedhojë, nisur edhe nga orientimet dhe qëndrimet e Kolegjit, si në vendimin nr. 15/2021 (JR), duhet të vlerësohet legjitimiteti i këtyre burimeve në origjinë. Ndërkohë që, për sa u takon

shumave të depozituara deri në vitin 2014, ato janë analizuar më sipër dhe ka rezultuar një pamundësi financiare me burime të ligjshme. Në vijim, çmohet e nevojshme të analizohet mënyra dhe legjitimitimi i përfitimit të shumës 4,161,365 lekë nga babai i subjektit në datën 30.10.2015.

4.2 Nisur nga të dhënat e administruara dhe shpjegimet e subjektit, ka rezultuar se në datën 31.10.2015, në llogarinë dyemërore të prindërve të subjektit dhe në favor të tyre, është kryer transferata e shumës 4,161,365 lekë, me këtë përshkrim: *“A. sh.p.k. kalon për E. ose Sh. B. sipas procesverbalit të ankandit”*.

Nga shqyrtimi dhe analizimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni, lidhur me veprimet përmbare nga njëra anë dhe pretendimet e financiare të babait të subjektit nga ana tjetër, në raport me ligjshmërinë e veprimeve të kryera nga përmbareuesi, si dhe të përfitimit dhe përvetësimit të shumës në fjalë nga babai i subjektit – duke i përshkruar faktet dhe rrethanat në mënyrë të përmbledhur dhe kronologjike – ka rezultuar sa vijon:

- a. Në vitet 1999 dhe 2000, shtetasi italian R. S., në cilësinë e administratorit të shoqërisë “C. A. S.” sh.p.k., ka dhënë një prokurë të përgjithshme dhe të posaçme për shtetasin E. B. (babai i subjektit), të zbatojë detyrat dhe të ushtrojë të drejtat që burojnë nga statuti i shoqërisë në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- b. Sipas një shkresë të thjeshtë (me shkrim dore), datë 8.2.2000, z. R. S., kishte njohur marrjen e një huaje nga z. E. B., në periudhën gusht 1993 – nëntor 1994, në shumën 45.000 USD.
- c. Bazuar në prokurat e lartpërmendura, në cilësinë e përfaqësuesit, z. E. B., në vitin 2013, ka lidhur një kontratë shërbimi me shoqërinë përmbare “A.” sh.p.k., me administrator, z. B. N., me qëllim ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë që t’i njihet z. R. S. të drejta kreditore të konsiderueshme nga persona të tretë (R. B.);
- d. Ndërkohë, z. E. B., kishte paraqitur një padi civile ndaj z. R. S., lidhur me detyrimin monetar të lartpërmendur (pika “b”) dhe me vendimin nr. ***, datë 2.6.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka pranuar pjesërisht padinë e tij dhe i ka njohur z. E. B. kredinë e pretenduar nga z. R. S.. Por, ky vendim në datën 15.10.2015, është ankimuar nga z. R. S. dhe me vendimin nr. ***, datë 3.11.2017, Gjykata e Apelit Tiranë ka prishur vendimin e shkallës së parë, për hetime të paplota dhe për vendimmarrje të bazuar, duke e rikthyer për rigjykim me një tjetër trup gjykues.
- e. Veç të tjerash në këtë vendim rezulton se z. E. B., nëpërmjet akteve të depozituara në gjykatë, në argumentimin e kërkesës për një masë të sigurimit të padisë, ka deklaruar se: *“[...] z. R. S. (i padituri) ka kërkuar disa muaj më parë që zyra përmbare ‘A.’ sh.p.k., të pezullojë ekzekutimin e veprimeve përmbare për kredinë e tij [...]”*. Ky fakt ngre dyshime mbi ligjshmërinë e veprimeve të mëtejshme të fazës së ekzekutimit përmbare sepse ato duken të vesuara nga mungesa e vullnetit të kreditorit, pasi janë vijuar dhe konkluduar në përmbushje të vullnetit të përfaqësuesit (E. B.), ndonëse vullneti i këtij të fundit nuk mund të prevalojë mbi atë të personit të përfaqësuar (R. S.).
- f. Në datën 30.10.2015, shoqëria përmbare “A.” sh.p.k., nëpërmjet z. B. N. – ndonëse më herët ishte kërkuar pezullimi i ekzekutimit dhe ndonëse kishin kaluar 15 ditë, pasi ishte apeluar vendimi i shkallës së parë mbi pretendimet e z. E. B. ndaj z. R. S. – ka transferuar

(në mënyrë të dyshimtë) në llogarinë dyemërore të prindërve të subjektit dhe në favor të tyre shumën 4,161,365 lekë, që i përkiste z. R. S. dhe shoqërisë së tij, në cilësinë e kreditorit.

- g. Në vijim, shuma në fjalë prej 4,161,365 lekësh është përvetësuar nga prindërit e subjektit dhe ka qëndruar në llogarinë e tyre deri në momentin e pasurisë nga nëna e subjektit, kur ky i fundit ka tërhequr pjesën e tij takuese të trashëguar nga kjo shumë, në masën 702,460 lekë = 1/9, duke e depozituar, më pas, në një tjetër llogari të nënës.

Në një vlerësim të fakteve të përshkruara më sipër, konstatohet se shuma në fjalë prej 4,161,365 lekësh është transferuar dhe është përfituar/përvetësuar në mënyrë të padrejtë dhe jo legjitime nga prindërit e subjektit të rivlerësimit. Në të gjitha rastet, edhe sikur kjo shumë të rridhte nga një kthim detyrimi, legjitim prej z. R. S., atëherë do të duhej të hetohej burimi në origjinë i huakthyesit (R. S.), si dhe burimi i ligjshëm në momentin e dhënies së huas në vitin 1993/94 nga babai i subjektit. Nisur nga periudha kohore e huadhënies dhe nga faktet të njohura botërisht mbi situatën ekonomike asokohe në Shqipëri, inflacionit të lartë deri në vitin 1992, etj., të ardhurat e asaj periudhe prej 58,683 lekësh, në mungesë të provës së të kundërtës konsiderohen dukshëm të pamjaftueshme për të krijuar kursime në masën 45,000 USD deri në vitin 1993 apo 1994. Gjithashtu, në shqyrtim të kërkesëpadisë së kryer nga babai i subjektit në vitin 2015, ka deklaruar se asokohe nuk ka marrë as pagën prej shoqërisë punëdhënëse/huamarrëse, që ndonëse jo të ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, do të mund të krijonin një disponibilitet financiar faktik, qoftë edhe të pjesshëm.

Për rrjedhojë, mungesa e legjitimitetit për përfitimin e shumës në analizë, e gërshetuar me paprovueshmërinë e burimeve të ligjshme financiare që kanë mundësuar kursimet në shumën 45,000 USD në vitin 1993, afekton, për pasojë, edhe të ardhurat e përfituara në vitin 2015 dhe të disponuara në momentin e deklaratës *Vetting* dhe, më pas, të përdorura nga nëna subjektit në investimin e vitin 2019, për blerjen e apartamentit të sipërcituar të ndodhur në rrugën “M. P.”, Tiranë.

Në vijim, bazuar në sa më sipër është përshkruar dhe arsyetuar, duke mos e konsideruar shumën 4,161,365 lekë si të ardhura me burim të ligjshëm, si dhe duke mos përfshirë në këtë analizë të gjitha kursimet e depozituara deri në vitin 2014 në llogaritë e prindërve të subjektit – për sa kohë nuk është provuar burimi i ligjshëm, sipas nenit D, të Aneksit të Kushtetutës – rezultati i analizës financiare të prindërve të subjektit, për blerjen e pasurisë në analizë, konsiston në një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 6,821,511 lekë, sikurse është pasqyruar në tabelën në vijim.

	TOTAL
PASURIA	9 049 183,10
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	9 049 183,10
TË ARDHURA	8 642 641,79
Të ardhura të subjektit	0,00
Të ardhura të babait	2 950 976,69
Të ardhura të nënës	4 980 181,11

Të ardhura të vëllait nga puna në Shqipëri	711 484,00
Të ardhura të vëllait nga puna në emigracion	0,00
Të ardhura nga shitja e pasurive të paluajtshme	0,00
Të ardhura nga shitja e pasurive të luajtshme	0,00
Të ardhura nga shoqëria përmbarimore "A." sh.p.k.	0,00
SHPENZIME	6 414 969,50
Shpenzime jetike	6 414 969,50
Rezultati i analizës financiare	- 6 821 510,81

Nisur nga pamjaftueshmëria financiare e konstatuar, lidhur me burimet e mjeteve monetare të përdorura nga nëna e subjektit në momentin e blerjes së pasurisë në analizë, pa u ndalur ngushtësisht në këtë moment, çmohet të përqendrohet fokusi deri në deklaratën *Vetting*. Kësisoj duhet të kryhet vlerësimi dhe verifikimi i ligjshmërisë së burimeve që kanë mundur kursimet e personave të lidhur, prindërit e subjektit, përgjatë periudhës që ky i fundit, jo vetëm që jetonte së bashku me ata, por ishte edhe në detyrën e prokurorit.

Në këtë këndvështrim, çmohet se këto pamjaftueshmëri financiare të konsiderueshme, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, gërma "b" e ligjit nr. 84/2016 – për sa kohë i referohen një periudhe pas emërimit të subjektit si prokuror dhe përgjatë bashkëjetesës me prindërit e tij, – mjaftojnë për të aplikuar një masë disiplinore, sipas pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, si një shkak më vete shkarkimi, pasi subjekti mbart detyrimin që të justifikojë burimet e ligjshme të krijuara edhe nga personat e lidhur (deri në deklaratën *Vetting*). Kësisoj, duke mbajtur në vëmendje, veç sa më lart, edhe pamundësitë financiare të konstatuara lidhur me analizën financiare të kryer nga Komisioni për vet subjektin, (ndonëse të pamjaftueshme në vetvete), si dhe lidhur me mungesën e mjeteve monetare me burim të ligjshëm për blerjen e autoveturës nga bashkëjetuesja e tij, në muajin maj të vitit 2013, arrihet në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti një nivel të besueshëm për kriterin e pasurisë.

Gjithashtu, duke mbajtur në vëmendje qasjen dhe shpjegimet jo bindëse të subjektit, mbi padijeninë e tij lidhur me përfitimin nga prindërit e tij të shumës së konsiderueshme prej 4,161,365 lekë, nëpërmjet një procedure ekzekutimi, të kryer me përfaqësimin e babait të tij për llogari të personave të tretë, – për sa kohë kjo situatë ndërthuret edhe me vlerësimin profesional mbi konflikt të mundshëm interesi dhe me disa denoncime nga publiku – çmohet se kjo rrethanë, duke mbajtur në vëmendje jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit⁶ dhe në zbatim të pikës 2, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, do të vlerësohet në tërësinë e procesit të rivlerësimit së bashku me rrethana e fakte të tjera të ngjashme, lidhur me cënimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë në Shqipëri.

5. Lidhur me vlerësimin aftësive profesionale

Në vlerësim të pakicës – veç problematikave të konstatuara dhe të çmuara si të tilla edhe në përfundimin e arritur nga shumica – vërehen edhe rrethanat si vijon.

⁶ Vendimi nr. 15/2021, i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

a- Lidhur me denoncimin e shtetasës M. D..

Ndryshe nga konkluzioni i shumicës, që subjekti ka vepruar sipas ligjit, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse lidhur me moskryerjen e hetimeve. Pra, edhe nëse ka kryer veprime në përputhje me dispozitat ligjore, kjo nuk e përjashton mundësinë që nuk ka kryer verifikime të plota dhe që ka vendosur mosfillimin lidhur me kallëzimin nr. ***, për veprën penale “shpërdorim detyre” nga punonjësit e IMT-së, Bashkia Tiranë. Kjo, pasi subjekti do të duhej të regjistronte procedimin penal dhe të urdhëronte kryerjen e hetimeve për të hedhur mjaftueshëm dritë mbi rrethanat e kallëzuarës.

Kjo mangësi hetimore është evidentuar edhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal dhe nisjen/vazhdimin e hetimeve lidhur me kallëzimin penal nr. ***.

b- Lidhur me denoncimin e shtetasve R. dhe H. B..

Në ankesën e tyre, këta shtetas kanë ngritur dyshime për veprime favorizuese të zyrës përmbartimore “A.” sh.p.k. dhe përmbartuesit gjyqësor B. N., ndaj subjektit të rivlerësimit dhe babait dhe i kërkojnë prokurorit të çështjes (një tjetër subjekt rivlerësimi), të transferojë procedimin e nisur mbi bazën e kallëzimit të tij në një tjetër prokurori, për të eliminuar mundësinë e ndikimit të subjektit E. B. në këtë çështje.

Sipas denoncuesit, subjekti është i përfshirë në afëra korruptive, ka përdorur dokumente të falsifikuara brenda ambienteve të prokurorisë, si dhe ka ushtruar presion psikologjik ndaj tij dhe gjyqtarëve. Denoncuesi pretendon se subjekti në bashkëpunim me përmbartuesin B. N. (administrator i zyrës përmbartimore “A.” sh.p.k.) kanë shitur banesën e tij, duke mos zbatuar rregullat e zhvillimit të ankandit.

Procedura përmbartimore e ndjekur nga zyra përmbartimore “A.” sh.p.k. është shqyrtuar gjatë hetimit të kryer nga Komisioni për kriterin e pasurisë. Nga ky shqyrtim nuk janë evidentuar shkelje procedurale të përmbartuesit gjyqësor, lidhur me respektimin e procedurave në momentin e nisjes dhe vijimësinë e fazës së ekzekutimit.

Por, në vlerësim të pakicës – duke analizuar edhe aktet gjyqësore të cituara në pikën 4.2, përgjatë analizimit të mënyrës së përfitimit të shumës 4,161,365 lekë nga prindërit e subjektit, nëpërmjet transfertës bankare të kryer nga z. B. N. në datën 30.10.2015 – janë evidentuar dy fakte që ngrenë dyshime mbi një favorizim të babait të subjektit për të përfituar shumën në fjalë në llogarinë e tij dhe më pas duke e përvetësuar atë. Konkretisht: (i) zyra përmbartimore nuk e ka pezulluar procedurën e ekzekutimit, sikurse e ka kërkuar kreditori (R. S.) i përfaqësuar nga babai i subjektit; dhe (ii) ndonëse z. E. B. ishte përfaqësues i kreditorit, shumat nuk janë kaluar në llogarinë e shoqërisë kreditore apo të administratorit (R. S.), por në llogarinë dyemërore të prindërve të subjektit. Rrethana këto, të cilat bëjnë të lindin dyshime për veprime favorizuese të përmbartuesit në favor të babait të subjektit të rivlerësimit, për të cilat ky i fundit zgjodhi të mos jepte shpjegime bindëse në seancën dëgjimore, duke u shprehur se nuk kishte dijeni mbi këto fakte dhe nuk e njihte dinamikën e përfitimit të këtyre shumave.

Gjithashtu, nga dokumentacioni i administruar, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka hetuar dhe ka vendosur pushimin e një procedimi penal të regjistruar ndaj shtetasit B. N., për shpërdorim detyre në vitin 2016, pak muaj nga momenti i përfundimit të procedurës së

ekzekutimit, të konkluduar me transfertën e lartpërmendur, datë 30.10.2015. Kjo rrethanë, në vlerësim të pakicës, përbën një konflikt interesi të subjektit, i cili duhej të ishte dorëhequr nga kjo çështje.

Në konkluzion, duke mbajtur në vëmendje edhe jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit⁷, çmoj se faktet dhe rrethanat e përshkruara më lart pasqyrojnë ekzistencën, jo vetëm të një konflikti interesi, por të para në tërësinë e tyre, së bashku me problematikat profesionale të konstatuara edhe nga shumica – të cilat, ndonëse nuk mjaftojnë për të aplikuar një masë disiplinore, sipas pikës 4, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, si një shkak më vete shkarkimi – të gërshetuara dhe të vlerësuara së bashku me të gjitha problematikat e tjera të evidentuara në pikat e mësipërme [që nuk plotësonin kushtet për të mbështetur/kontribuar (në) aplikimin e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016], parë në tërësinë e procesit të rivlerësimit, sipas pikës 2, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, krijohet bindja se mjaftojnë për të arritur në konkluzionin se subjekti ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

Për pasojë, në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që Komisioni disponon për kriterin e vlerësimit e pasurisë, si dhe në vlerësimin tërësor të këtij rivlerësimi, si anëtar në pakicë/kundër, arrij në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në rivlerësimin e pasurisë, ka cenuar besimin e publikut dhe, për rrjedhojë, në këtë rast duhet të gjenin aplikim pikat 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Unë, si anëtar në pakicë, vlerësoj se vendimi i shumicës së trupit gjykues, që ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit, nuk është i drejtë, pasi nuk janë përmbushur të gjitha kushtet e pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016. Për arsyet e sipërcituara, sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të pikave 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, si dhe parë në tërësinë e procesit të rivlerësimit, sipas pikës 2, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në provat që disponon Komisioni, subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për vlerësimin e pasurisë dhe ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë dhe, për rrjedhojë, krijohet bindja se duhet të ishte disponuar shkarkimi i subjektit nga detyra.

ANËTAR/kundër
Lulzim Hamitaj

⁷Vendimi nr. 15/2021, i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.